



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 24. 10. 2011, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Biserka Kostiq Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyqi, Justina Pula dhe Kymete Bajraktari.

Mungoi: Duda Balje.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi dhe Floriana Shala- OSBE, Ukë Gashi- ZPRK, Visar Bivolaku- EUSR, Florije Kryeziu- UNICEF dhe Nuredin Ibishi - Këshilltar i kryetares të Komisionit nga CDF-i.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi Suazan Novoberdali, kryetare, e cila konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 tetor 2011
3. Shqyrtimi i petitionit të Koalicionit ad-hok të OJQ- ve në mbrojtje të Qendrës historike të Prizrenit lidhur me Projektligjin.
4. Miratimi i raportit të lidhur me monitorimin e ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.
5. Miratimi i fushëveprimit dhe përgjegjësiive të Komisionit sipas propozimit të Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit.
6. Miratimi i planit të punës së Komisionit për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2011.
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Albana Gashi propozoi që pika e pestë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës pasi që nuk ka pasur kohë të sjellë propozimet.

Kryetarja propozoi që pikat e rendit të ditës të shqyrtohen ashtu si janë për të mos humbur kohë dhe tha se nëse dikush ka propozime shtesë mund t'i sjellë edhe në mbledhjen tjetër.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 tetor 2011

Kryetarja- Tha se procesverbalet janë shpërndarë në të dy gjuhët zyrtare.

Biserka Kostiq - Pati vërejtje rreth diskutimit të saj lidhur me materialin dhe tha se nuk është e vërtetë se kam kërkuar që materiali të më dërgohet vetëm në gjuhën serbe, por kam theksuar se materiali të më ofrohet në gjuhën amtare, prandaj kjo nuk më mundon mua.

Albana Gashi- Unë kisha vërejtje në procesverbal, por nga administrata ato vërejtje tani veç qenkan inkorporuar.

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 12 tetor 2011 u miratua me vërejtjet dhe plotësimet e dhëna nga Albana dhe Biserka.

3. Shqyrtimi i peticionit të Koalicionit ad-hok të OJQ- ve në mbrojtje të Qendrës historike të Prizrenit lidhur me Projektligjin.

Kryetarja- Tha se ky projektligj ka qenë në Kuvend në shqyrtim të parë dhe është kthyer në Qeveri. Qeveria pa asnjë ndryshim e ka sjellë Projektligjin prapë në Kuvend. Tani ne e kemi këtë peticion, i cili është i nënshkruar nga dhjetë mijë qytetarë që besoj e keni marrë të gjithë, e keni analizua të gjithë edhe peticionin, por edhe projektligjin. Prandaj lidhur me këtë pikë të rendit të ditës hapi debat se çka mendojnë edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

Kymete Bajraktari- Tha se sa i përket këtij peticioni unë e përkrahi plotësisht, sepse peticioni është shumë i drejtë dhe se ekziston një arsye shumë e fortë, jemi duke e bërë monitorimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë. Ne kemi kërkuar ta vizitojmë kishën ortodokse në Prizren dhe nuk jemi lejuar të shkojmë. Unë mendoj se kjo është shkelje e të drejtave të njeriut, nuk e di se çfarë statusi duhet për të pasur për të shkuar për ta monitoruar Ligjin? Kjo është arsyeja që unë e mbështes peticionin e qytetarëve të Prizrenit,

Albana Gashi- Edhe unë e mbështes peticionin që e kanë bërë koalicioni ad-hok për mbrojtjen e Qendrës historike të Prizrenit. Këtu u panë që janë përmbi dhjetë mijë nënshkrime që janë kundër këtij projektligji, i kemi parë edhe kërkesat e tyre që janë

hartimi që nga fillimi i këtij projektligji dhe pjesëmarrja e qytetarëve të Prizrenit në këtë projektligj. Ky është një Peticion që është bërë për tri ditë dhe kur kanë arritur për tri ditë të mbledhen dhjetë mijë nënshkrime, përse e kanë lënë kohën e shkurtër, ka qenë ajo se mos po vjen projektligji shpejt në Kuvend dhe janë ngutur për punën e procedurave. Kështu që përveç asaj që kemi parë në këtë peticion, kemi parë që edhe nuk është marrë parasysh edhe rekomandimi i Kuvendit nga ana e Qeverisë për ndryshim dhe për hartim nga fillimi, por na është sjellë ky projektligj pa asnjë presje ndryshim dhe po të servohet i njëjti projektligj që nuk është miratuar herën e parë, po vjen herën e dytë i njëjti pa asnjë ndryshim. Kështu që jam plotësisht kundër saj, në anën tjetër po shkelet edhe Kushtetuta e Kosovës në këtë rast, përkatësisht neni 39, konfesionet fetare janë paragrafët 1 dhe 2, kështu që i kemi të gjitha arsyet për ta hedhur poshtë këtë projektligj dhe për ta kthyer prapë në Qeveri. Unë e mbështes këtë peticion.

Justina Pula- Tha se ka një pyetje. Ky ligj ka qenë në Kuvend, nuk është miratuar dhe është kthyer në Qeveri. Tani kemi peticionin, mua po më intereson procedura, a mundet ligji të procedohet në Kuvend, pa e analizuar këtë peticion si komision.

Kryetarja- Ne duhet ta shqyrtojmë peticionin i cili na është adresuar. Ne jemi Komision kompetent për këtë. Ne duhet të fokusohemi në aspektin e shkeljes së të drejtave të njeriut, e kem projektligjin dhe duhet ta shikojmë se ky projektligj a bën shkelje të drejtave apo jo? Unë e kam analizuar këtë projektligj dhe i kam disa vërejtje. Me këtë projektligj ka edhe shkelje të Kushtetutës, ka diskriminim.

Rita Hajzeraj- Tha se të gjitha këto që i thatë si vërejtje qëndrojnë. Jemi të gjithë të vetëdijshëm që po shkelet Kushtetuta. Është edhe shkelje e të Drejtave të Njeriut, mirëpo që ua merr menja juve Qeveria a i di këto shkelje, a e di Kushtetutën dhe që po i bën këto shkelje, kur në të njëjtën mënyrë po e kthen ligjin pa asnjë vërejtje, asnjë ndryshim. Ne s'jemi Komisioni i parë që po e zbulojmë se po shkelet Kushtetuta me këtë projektligj. Unë konsideroj që si Komision duhet të merremi me peticionin i cili është bërë prej qytetarëve të Prizrenit. Ata plotësisht kanë të drejtë nëse për tri ditë kanë arritur të mbledhin dhjetë mijë nënshkrime, atëherë merreni me mend se për një javë ose për një muaj, sa nënshkrime apo sa ankesa do të bëhen? Ne, si Komision, mundemi me marrë një vendim se ky projektligj i shkel të drejtat e njeriut sipas peticionit dhe kërkesës së qytetarëve të Prizrenit, e më tutje janë komisionet e tjera, Kryesia e kuvendit që vendos për daljen e ligjit në seancë ose debat.

Kimte Bytyqi- I përshëndeti të gjithë të pranishmit, dhe tha se sa i përket peticionit nuk janë pak dhjetë mijë nënshkrime. Me këtë ligj shkelen plotësisht të drejtat e njeriut, Qeveria duhet të ketë kujdes se çka po vepron në këtë aspekt.

Kurtan Kajtazi- Unë nuk kam qenë i njoftuar se sot do të kemi peticionin në rend dite për shqyrtim në Komision. Është mirë ne, si Komision, të përgatitemi mirë dhe të përcaktohem se ku ka shkelje të drejtave të njeriut, t'i cekim pikat se ku bëhen shkelje. Unë kërkoj që në një mbledhje tjetër të radhës bashkërisht ta analizojmë edhe njëherë, meqenëse nuk jam i përgatitur tash.

Biserka Kostiq- Tha se unë nuk jam në dijeni se ku janë ato dhjetëmijë nënshkrime. Ato si ka parë askush, e sa i përket ligjit kjo nuk është diçka e re. Kjo është e paraparë me Pakon e Ahtisarit dhe ata e kanë pasur të qartë se duhet të vijë deri te kjo që ka ardhur. Ky projektligj duhet të mbrojë të gjithë trashëgimin kulturore dhe e gjitha pasuria i takon kishës serbe në Prizren. Ky projektligj njëherit garanton që të mos ndodh prapë ajo çka ka ndodhur më 17 mars. Ajo se a ka pasur shkelje të të drejtave se çka ka ndodhur, si është shkatërruar pasuria në atë kohë.

Albana Gashi- Tha se sa i përket mbledhjes së dhjetëmijë nënshkrimeve, vullneti kundër këtij projektligji ka qenë shumë i madh dhe nuk është shumë zor të mobilizohen dhjetëmijë qytetarë për tri - katër ditë. Kështu që jo dhjetëmijë, po sikur të kishte pasur mobilizim më të madh, kishin mundur të mblidhen njëzetmijë, ose tridhjetëmijë nënshkrime brenda këtyre tri ditëve. Kështu që nuk ma merr mendja që është një problem i madh edhe e kam cek edhe në mbledhjen e kaluar punën e nënshkrimeve të peticioneve. Komisioni i ynë nuk është ai që merret me ekspertiza, Pakoja e Ahtisarit meqë u përmend këtu, nuk përmendet ky projektligj edhe Qeveria edhe institucionet e tjera ndërkombëtare që thirren në Pakon e Ahtisarit shpeshherë në këtë rast ata vetë po e shkelin, sepse Pakoja e Ahtisarit aty shkruan se Komuna e Prizrenit e ka për obligim ta hartojë një rregullore për themelimin e Qendrës historike të Prizrenit edhe jo ta hartojë një ligj të veçantë. Me këtë rast meqë jemi të shkeljet, po shkelet edhe vetë Pakoja e Ahtisarit. Sa i përket 17 marsit ndikimi i kishës ortodokse ka nxitur urrejtje tërë kohën dhe kjo është arsyeja pse ato kisha janë djegur. Kjo ka qenë njëra nga arsyet që ato kisha që i përmendët ju, janë djegur. Kështu që nëse ne prapë vazhdojmë me kalimin apo transferimin e autoriteti publik në atë fetar, ma merr mendja që shpeshherë ka me u përsërit ajo, ju faleminderit.

Justina Pula- Tha se më intereson që në momentin që konstatojmë se ka shkelje të të drejtave të njeriut a mundemi ne ta bëjmë një raport e ta cekim se në cilat pika ka shkelje? Unë nuk e përkrahi ligjin dhe kam dilema të mëdha se çka duhet bërë me atë projektligj, por si Komision të dalim me përfundime serioze.

Kymete Bajraktari- Tha se jam e autorizuar në emër të Komisionit ta bëj monitorimin e Ligjit për liritë fetare. Në asnjë bashkësi fetare nuk kanë kërkuar të kem leje të veçantë për kontaktim, kur jam njoftuar se për ta vizituar kishën ortodokse duhet të kem leje të veçantë, ka qenë diçka për mua e pa pranuar (absurde)! Ndërhyn OSBE-ja për të kërkuar një leje për ta vizituar kishën ortodokse, me qëllimin më të mirë për të shkuar për ta monitoruar ligjin për liritë fetare. Dhe nuk lejohemi, çfarë statusi duhet për të pasur për të shkuar për ta vizituar atë kishë ortodokse, dhe ky projektligj vetëm sa ka për ta përforcuar atë se na kurrë nuk do t' i vizitojmë ato kisha.

Rita Hajzeraj- Tha se secili prej nesh e di se për çka po bëhet fjalë, ka qenë në seancë e dimë se çfarë ligji kompleks është. Meqë u përmend Pakoja e Ahtisarit për këtë çështje këtë po e citoj se çka thotë pika 4.1.7 zona e mbrojtur për Qendrën historike të Prizrenit përcaktohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM- në dhe do të përfshijë objektet e kishës ortodokse, objektet otomane, objekte fetare çka do të thotë që nuk bien në fushëveprimtarinë e Kuvendit të Kosovës, nuk duhet të nxjerrim ne ligj enkas

për këtë qendër. Ne është mirë të kërkojmë sqarim, si Komision prej Qeverisë pse e ka kthye këtë projektligj pa asnjë ndryshim, dhe nuk ka kurrgjë të paqartë se çfarë sqarime duhet me dhënë ne për këtë projektligj. Kur shihet qartë se shkelet Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Pakoja e Ahtisarit,

Ne këtë peticion duhet për ta shikuar se a i ka plotësuar kushtet për peticionin dhe se peticionin duhet për ta shqyrtuar, si Komision, janë shkelur të drejtat e njeriut, i kemi faktet dhe e përkrahim si peticion.

Kurtan Kajtazi- Kam një propozim, vërejtjet që u dhanë nga anëtarët e tjerë të Komisionit, me këto vërejtje të përgatitet një raport dhe në mbledhjen e ardhshme të votohet.

Kryetarja- Me raporte nuk mundemi të dalim pa marrë Komisioni një vendim. Të shihet se ku mendon Komisioni që ka shkelje të të drejtave të njeriut.

Albana Gashi- Janë dy kërkesa të qytetarëve, aty të kthehet projektligji prapë të hartohet prej fillimi dhe të marrin pjesë qytetarët e Prizrenit, shumë të qarta janë kërkesat.

Kryetarja- Meqë kemi anëtarë që s'mund ta shprehin mendimin e vet për shkak se nuk e kanë analizua peticionin, atëherë për këtë pikë nuk po marrim vendim sot dhe këtë e vendosim në mbledhjen e ardhshme.

4. Miratimi i raportit të lidhur me monitorimin e ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Kryetarja- Tha se puna rreth monitorimit të ligji ka përfunduar, është përgatitur raporti, raportuesja Albana Gashi e ka krye këtë punë me sukses dhe e falënderojmë. Ajo tha se ka pasur një rekomandim që duhet të përfshihet, se viktimat e dhunës në familje nuk duhet të dalë nga shtëpia, por kryerësi i cili ka shkaktuar dhunë në familje.

Albana Gashi- Tha se rekomandimi është i përfshirë në raport, por në të gjitha takimet dhe vizitat që i kemi pasur nuk kemi hasur në atë se viktimat është e detyruar të dalë nga shtëpia. Kjo është për shkak të mentalitetit dhe traditës, por kjo gjithsesi është e përfshirë në raport. Unë kam vetëm një ndryshim që të përfshihet, është ngritja e dënimeve, sepse dënimet janë shumë të ulëta.

P e r f u n d i m

Komisioni unanimisht miratoi raportin për monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe vendosi që ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

5. Miratimi i fushëveprimit dhe përgjegjësi të Komisionit sipas propozimit të Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit

Kryetarja- Tha se Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit ia kemi përcjellë propozimet rreth emërimit të Komisionit dhe asaj që Komisioni të bëhet

komision i përhershëm. Ne kemi fushëveprimtarinë e Komisionit tonë në atë se çka jemi kompetent të shqyrtojmë dhe të bëjmë. Nëse keni diçka shtesë, unë kërkoj që të sjellën propozimet në mbledhjen tjetër.

6. Miratimi i planit të punës së Komisionit për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2011.

Kryetarja- Tha se tani nuk i kemi gjashtë muaj, por me pak. Kemi përgatitur një plan të punës për këta muaj.

Rita Hajzeraj- Tha se në muajin nëntor e kemi shqyrtimin dhe amendamentimin e ligjit për barazi gjinore. Jemi Komisioni i vetëm që nuk kemi pasur asnjë vizitë jashtë vendit, ka shumë projektligje në vendet e tjera që mund t'i shohim se si zbatohen. Prandaj duhet të bëjmë përpjekje për ta realizuar një vizitë jashtë vendit për t'i parë praktikat e vendeve të tjera.

Kryetarja- Tha se plani i punës që është prezantuar nuk është definitiv, ky do të plotësohet, ndryshohet varësisht prej kërkesave dhe nevojave që do të dalin.

Përfundim

Komisioni unanimisht miratoi planin e punës për periudhën që ka mbetur deri në fund të vitit.

7. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu